



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I6-2 Prot.
Nr.doc. 202300152/2

Tiranë 28.02.2023

Lënda : *Rekomandim për ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Fier për një vlerësim të plotë e gjithpërfshirës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom që banon në fshatin Drizë, Fier, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.*

BASHKISË FIER

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit, në ushtrim të funksionit të tij kushtetues në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut, një ndër prioritetet e punës së tij ka mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të minoriteteve kombëtare. Bazuar në njoftimet e bëra publike në media, dhe më konkretisht në median online "Faxëeb.al", me titull: "**12 familje rome në Drizë të Fierit penalizohen për ndihmën ekonomike, paralajmërojnë për protestë**"¹, në përputhje me nenin 13, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me iniciativë të kësaj problematike, që lidhet me kushtet e jetesës së këtij komuniteti.

Problematika e paraqitur lidhet me ndërprerjen e ndihmës ekonomike për një grup anëtarësh të minoritetit kombëtar Rom, banues në fshatin Drizë. Sipas informacionit të bërë publik, qytetarët ngrenë disa pretendime lidhur me mosnjoftimin në kohë nga

¹ <https://www.faxweb.al/12-familje-rome-ne-drize-te-fierit-penalizohen-per-ndihmen-ekonomike-kryeplaku-i-fshatit-po-detyrohen-te-lypin-ne-durres-per-buken-e-gojes-do-dalim-ne-proteste/>

administratori i njesisë administrative Qendër për aplikimet, moskryerjen e procedurave për shkak të problemeve teknike të sistemit, duke i penalizuar ata për shkak të tejkalimit të afateve për aplikim, etj.

Pasi është njohur me rastin, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se këto familje janë duke u përballur me kushte mbijetese, çka shkon përtej trajtimit të fragmentuar të problematikës vetëm për sa i përket ndihmës ekonomike. Kjo adreson nevojën që rasti të lidhet ngushtësisht me vlerësimin tërësor të kushteve minimale të jetesës, strehimit e përshtatshëm e dinjitoz me standardet e përcaktuara në legjislacionin për strehimit social, arsimin minimal, mungesën e aksesit në shërbimet publike për shkak të varfërisë apo panjohurisë së ligjit, etj., për këtë komunitet.

Për këtë situatë, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer një sërë veprimesh në kuadër të hetimit administrativ, duke kërkuar informacion dhe shpjegime pranë disa strukturave në nivel vendor.

Konkretisht, me tonën nr. K1/I95-2 datë 09.11.2022 kemi kërkuar shpjegime nga Bashkia Fier lidhur me masat e marra pas publikimit dhe denoncimit të rastit në media, bazueshmërinë e këtij rasti, ndihmën që mund të jepet sipas legjislacionit në fuqi për mbështetjen e këtij komuniteti, në ofrimin e shërbimeve sociale, në interes të fuqizimit ekonomik të tyre, duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve dhe shëndetin e të sëmurëve në përbërje të tyre, si dhe çdo informacion në lidhje me zgjidhjen e problematikës me të cilën po përballen qytetarët.

Bashkia Fier, me shkresën nr.9841/1 prot., datë 16.11.2022, bën me dije ndër të tjera se “ ...fshati Rom (Drizë) ka rreth 350 familje por, sot aktualisht nuk janë më shumë se 150 të tilla, pasi pjesa tjetër janë larguar në emigracion. Banorët e këtij fshati nuk janë trajtuar nga ligji 7501, pra nuk disponojnë tokë në pronësi, një pjesë e mirë e tyre jetojnë në vështirësi ekonomike, dhe kanë probleme me analfabetizmin, duke vështirësuar kuptimin dhe zbatimin e kërkesave ligjore për përfitimin e ndihmës ekonomike. Aktualisht në Njesinë Administrative Qendër (pjesë e të cilës është edhe fshati Rom-Drize), trajtohen gjithsej në sistemin e ndihmës ekonomike 50 familje, nga të cilat 34 (ose rreth 68%) i përkasin komunitetit Rom ...” . Po kështu, në përgjigjen e sipërcituar të bashkisë pranohet fakti i penalizimit të përfituesve për shkak të mosparaqitjes për çdo tre muaj për firmosjen e deklaratave përkatëse që kërkon procedura, duke u shprehur se “... pothuajse të gjithë përfituesit nuk janë të rinj në skemë, por kanë me vite dhe e njohin mirë këtë procedurë...” duke vijuar më tej se “... duhet kuptuar nga të gjithë se zbatimi i ligjit është detyrë dhe jo dëshirë, e

kjo vlen për çdo njeri, pavarësisht se kujt komuniteti i takon ...” Përgjigja konkludon me fjalinë se “ ... inatet dhe pakënaqësitë personale nuk duhet të jenë objekt trajtimi apo të merren si të vërteta ...”.

Ndërkohë, në përgjigjen e Bashkisë, anashkalohet kërkesa për shpjegime e institucionit të Avokatit të Popullit sa i takon kushteve të mjerueshme të banesës së njërit prej ankuesve, i cili është shprehur se ndonëse ka kërkuar vazhdimisht një vlerësim të kësaj situatë nga Bashkia, askush nuk i është përgjigjur.

Pas kërkesës së përsëritur të institucionit të Avokatit të Popullit, nr. K1/I95-6 datë 27.12.2022, Bashkia Fier, me shkresën nr. 9841/2 datë 05.01.2023 është shprehur se i mbetet të njejtit informacion të dërguar me shkresën nr. 9841/1 prot., datë 16.11.2022.

Për sa më lart, në vlerësim të kujdesshëm të qendrimit të mbajtur nga Bashkia Fier për rastin në fjalë, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se shfaqen një sërë problematikash të cilat kanë të bëjnë jo vetëm me detyrimin e ushtrimit të kompetencave nga ana e organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve publike, por edhe me cilësinë dhe kushtet e jetesës së një komuniteti banorësh, pjesë e minoritetit kombëtar Rom në vendin tonë.

Përmbushja e detyrimeve, që rrjedhin nga angazhimet ndërkombëtare por edhe nga kuadri ligjor e strategjik i brendshëm për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit Rom, me qëllim që ky minoritet të jetojë me standartet e pjesës tjetër të popullsisë në vendin tonë, kërkon koordinim ndër-institucional, me rëndësi thelbësore për mbrojtjen më efektive të të drejtave të anëtarëve të këtij komuniteti.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 15 të saj, i cilëson të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, “*të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme*” dhe si bazë të gjithë rendit tonë juridik, duke sanksionuar kështu barazinë dhe ndalimin e diskriminimit për të gjithë individët të cilët, jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur dhe po ndjek në vazhdimësi këtë problematikë, e cila ngërthen në vetvete një sërë të drejtash themelore dhe që lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e jetës e rrjedhimisht të drejtën themelore të njeriut, të njohur si “*e drejta për jetën*”, e garantuar në nenin 21, të Kushtetutës.

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025², si një dokument i ri i politikave specifike për integrimin e

² Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 701 datë 18.11.2021.

Romëve dhe Egjiptianëve u atribuon njesive të vetqeverisjes vendore një rol të rëndësishëm, duke përçuar frymën e bashkëpunimit nga këto institucione si struktura të cilat duhet të luajnë një rol edhe më praktik dhe specifik bazuar në përgjegjësitë dhe fushën e zgjeruar të veprimtarisë së tyre, të mbështetur tek parimi i decentralizimit dhe reforma e administrimit territorial.

Bashkia Fier, si njësi e vetqeverisjes vendore duhet të luajë një rol më proaktiv, udhëhequr nga parimi i autonomisë vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, parim i cili në pikën 2, të nenit 2, të Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, përkufizohet si:

“...e drejta dhe aftësia e njesive të qeverisjes vendore, të krijuara sipas Kushtetutës dhe këtij ligji dhe në kuadër të kufizimeve të tij, që të rregullojnë dhe të administrojnë një pjesë thelbësore të çështjeve publike nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të bashkësisë”.

Sikurse përcaktohet shprehimisht në pikën 1, të nenit 8, të ligjit “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar:

“Organet e njesive të vetqeverisjes vendore mund të ndërmarrin nisma me interes publik vendor në territorin e juridiksionit të tyre për çdo çështje që nuk u ndalohet me ligj, ose që nuk i është dhënë ekskluzivisht me ligj një organi tjetër shtetëror”.

Disa nga aspektet sensitive të gjendjes aktuale të minoritetit kombëtar Rom në Shqipëri kanë të bëjnë me kushtet e tyre të vështira të jetesës, varfërinë, aksesin në shërbimet mjekësore, nivelin e ulët të arsimimit dhe kulturën e traditat Rome. Mungesa e kushteve minimale të jetesës së këtij minoriteti është një problem serioz, jo vetëm për këto komunitete, por edhe për ndihmën e ofruar nga shteti dhe shoqëria jonë për integrimin e plotë të Romëve në shoqëri. Kjo situatë bën që anëtarë të këtyre komuniteteve të ndihen të diskriminuar, të pabarbartë me pjesën tjetër të popullsisë dhe me mungesë shprese për të ardhmen.

Përkundrajt këtij realiteti, qasja që Bashkia Fier ka shprehur në shkresën nr. 9841/1 prot., datë 16.11.2022, veçanërisht me pohime të tilla si “... zbatimi i ligjit është detyrë dhe jo dëshirë, e kjo vlen për çdo njeri, pavarësisht se kujt komuniteti i takon, apo inatet dhe pakënaqësitë personale nuk duhet të jenë objekt trajtimi apo të merren si të vërteta ...” është shumë shqetësuese për Avokatin e Popullit. Ky qëndrim tregon mungesë të theksuar të qasjes së duhur të këtij institucioni për të siguruar qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve, referuar misionit të bashkisë si organ i pushtetit vendor që siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër

qytetarëve³, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Ndonëse Avokati i Popullit kupton dhe vlerëson nevojën për plotësimin e procedurave brenda afateve, qëllimi i këtij programi është të fuqizojë familjet më të dizavantazuara. Vëmendja ndaj këtyre grupeve duhet të jetë përmbajtësore ndaj, ndonëse detyrimi është i tyre, shpjegimi, njohja dhe shpallja publike e afatit për qytetarët është tregues i mirëqeverisjes. Qëasja proaktive e sjelljes së këtyre të institucioneve dhe rritja e ndërgjegjësimit për ligjin, si në radhët e këtyre grupeve ashtu edhe në përgjithësi, nëpërmjet metodave proaktive për t'i plotësuar mangësitë në njohuritë ligjore të personave që nuk dinë ku të drejtohen për të kërkuar informacion, është parashikuar edhe nga “Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga ana tjetër, vlerësojmë të sjellim në vëmendje faktin se organet e pushtetit vendor, si organet qeverisëse të cilat janë më afër qytetarit se çdo organ tjetër, duhet të kujdesen që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet në mënyrë arbitrare dhe jo proporcionale asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta.

Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupimeve të caktuara të qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj. Gjithashtu Bashkia duhet të mbështesë dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane, e për më tepër kur pjestarë të familjeve janë edhe të mitur. Bashkitë si ofruese të shërbimeve duhet të jenë më fleksibël për të dëgjuar e adresuar drejt qytetarët si dhe adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës.

Nga ana tjetër qendrimi i Bashkisë se *inatet dhe pakënaqësitë personale nuk duhet të jenë objekt trajtimi apo të merren si të vërteta*, tregon për mungesë të vullnetit për sjelljes të mirë administrative dhe bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit, i cili pasi ka marrë njoftim apo dijeni nga media për rastin ka iniciuar kryesisht hetimin administrativ, duke i dhënë Bashkisë mundësinë që, në bazë të parimit të kontradiktoritetit, të parashtrijë qendrimin e provat e saj për rastin në fjalë.

Në konkluzion të sa u parashtrua dhe arsyetua, vlerësojmë se sjellja e Bashkisë Fier përkundrejt adresimit të situatës në tërësi nuk garanton standardin e pritshëm për

³ Sipas nenit 3 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”

qeverisje dhe garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe aq më pak standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve, siç është e drejta për mbrojtjen sociale. Për të adresuar problemet e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, aq më tepër institucionet e pushtetit vendor, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve.

Problematika e kushteve të jetesës së minoritetit kombëtar Rom në vend ka qënë tashmë prej shumë vitesh në vëmendjen e institucionit të Avokatit të Popullit, i cili ka realizuar inspektime të vendbanimeve kryesore Rome në vend duke ndjekur dhe konstatuar nga afër gjendjen dhe kushtet e jetesës së familjeve dhe individëve pjestarë të këtij minoriteti, e duke rekomanduar edhe masat e përshtatshme për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom në zona të ndryshme të vendit.

Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, në këtë kuptim është e veshur me përgjegjësi efektive që mundësojnë një drejtim sa efikas, aq edhe afër qytetarit.

Marrja e këtyre masave shkon në të njëjtën linjë me përmbushjen e kriterëve politike që Bashkimi Europian ka vendosur ndaj vendit tonë, si kusht për procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Konkretisht, një nga këto kushte ka të bëjë me, përmirësimin e të drejtave të njeriut dhe të kushteve social- ekonomike, ku përfshihen si subjekte edhe minoritetet kombëtare në vend.

Për sa më sipër, me qëllim garantimin e një cilësie jetese më të mirë jetese për anëtarët e komunitetit Rom, në fshatin e njohur si “Drizë”, Njësia Administrative Qender, të Bashkisë Fier, bazuar në, nenin 1, të “Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut”, ku thuhet shprehimisht se:

“Të gjitha qëniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave”,

në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës, ku thuhet shprehimisht se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*,

dhe në vijim të nenit 21/b, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:

- *paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave të njeriut... ”.*

REKOMANDOJMË

- (i) Ushtrimin e plotë dhe efektiv të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Fier për një vlerësim të plotë e gjithpërfshirës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom që banon në fshatin Drizë, Fier, në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme;
- (ii) Realizimin e njoftimeve publike për afatet brenda të cilave duhet të bëhet plotësimi i dokumentacionit.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398 datë 12.05.2005, ku përcaktohet se:

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

lutemi, pas shqyrtimit, të n’a vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Vilma SHURDHA